



Ne prag te ndeshjes Skenderbeu-Tirana, interesimi i tifozerise korcare ka qene shume i madh. Te enjten kane dale ne shitje biletat dhe menjehere tifozet i jane drejtuar sporteleve. Brenda dy diteve mesohet te jene shitur me shume se gjysma e biletave qe kane dale ne shitje. Keshtu, rreth 2500 bileta mesohet te jene rezervuar e ne stadium pritet te kete edhe te tjere gje e cila do te sjelli nje atmosfere te elektrizuar. Ndeshja mes Skenderbeut dhe Tiranës do te luhet te shtunen ne oren 14:00.